

Sipas një sondazhi të realizuar nga Instituti Francez për Opinionin Publik, thuhet gjysma e shtetasve francezë mendojnë se nuk duhet të publikohen karikaturat e profetit Muhamed.

Sondazhi vjen disa ditë pas sulmit të 7 janarit mbi revistën satirike "Charlie Hebdo" ku u vranë 17 persona, raporton AA.

Janë 42 përqind e shtetasve francezë që mendojnë se karikaturat e profetit Muhamed nuk janë aspak të hijshme për tu publikuar.

Këta shtetas francezë të intervistuar kanë thënë në masë se karikaturat nuk duhen publikuar për shkak se fyejnë myslimanët.